

Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës është Organ i tretë Kolegjal më i rëndësishëm në UBT pas Senatit Akademik dhe Rektoratit.
2. Këshilli i Etikës ngrihet pranë UBT-së dhe promovon e shqyrton çështje që lidhen me ligjshmërinë, etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.
3. Këshilli i Etikës i UBT-së përbëhet nga një përfaqësues për çdo njësi kryesore të tij, një përfaqësues nga personeli administrativ, një nga personeli ndihmës-akademik dhe një përfaqësues i studentëve. Kur numri i anëtarëve të Këshillit të Etikës është çift, atëherë atij shtohet një anëtar i propozuar nga Senati Akademik.
4. Anëtarët e Këshillit të Etikës përzgjidhen nga Senati Akademik mbi bazën e propozimeve të bëra nga njësitë kryesore, në përbërje të të cilit janë punonjësit mësimorë me kohë të plotë si dhe studentë, Administratori për anëtarët e stafit të personelit administrativ, Rektori për personelin ndihmës-akademik dhe komuniteti i studentëve të UBT-së.
5. Të gjithë anëtarët e Këshillit të UBT-së duhet të kenë një përvojë pune në njësinë kryesore përkatëse prej të paktën pesë vitesh.
6. Anëtarët e Këshillit të Etikës kanë mandat katërvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
7. Anëtarët e Këshillit të Etikës nuk ushtrojnë funksione drejtuese në UBT.
8. Anëtarët e Këshillit të Etikës zgjedhin kryetarin e tij.
9. Këshilla të Etikës ngrihen edhe pranë fakulteteve, anëtarët e të cilit kanë mandat dy-vjeçar.
10. Detyrat dhe funksionet e Këshillit të Etikës përcaktohen në Kodin e Etikës së UBT-së dhe rregulloren e tij, të cilët miratohen nga Senati Akademik dhe BaUBT.